



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 maj 2022
Nr.ref.:RK1990/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI86/21

Parashtrues

Mirsad Bilibani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 287/2019, të 5 nëntorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mirsad Bilibani (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), nga Komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 287/2019] të 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3929/14] të 28 majit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 551/12] të 30 shtatorit 2013 të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 2 shkurt 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 maj 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
8. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 25 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 25 maj 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Gjykata Themelore për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.
12. Më 2 qershor 2021, Gjykata Themelore informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 shkurt 2021.
13. Më 18 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një dokument në mbështetje të kërkesës së tij të 7 majit 2021.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 30 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

16. Sipas shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës përmes Aktgjykimit [K. nr. 211/03] të Gjykatës Komunale në Prizren, të 14 majit 2003, ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale lëndim i rëndë trupor dhe ishte dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim.
17. Më 26 prill 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren pas inicimit të ankesës nxori Aktgjykimin [K. nr. 277/2003] përmes të cilit ndryshoi pjesën e vendimit lidhur me dënimin e përcaktuar në aktgjykimin e shkallës së parë dhe vendosi që parashtruesi i kërkesës të dënohej me 3 (tre) muaj burgim për kryerjen e veprës penale lëndim i rëndë trupor.
18. Më 30 shtator 2013, Gjykata Themelore pas paraqitjes së padisë nga pala e dëmtuar, respektivisht nga Z. K., nxori Aktgjykimin [C. nr. 551/12] përmes të cilit detyroi parashtruesin e kërkesës që palës së dëmtuar, në emër të kompensimit të dëmit, për shkak të shkakimit të lëndimeve të rënda trupore t'ia paguaj vlerën e tërësishme prej 11.292,00 euro brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, me kamatë ligjore, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.
19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit me arsyetimin për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 28 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3929/14] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 551/12] të 30 shtatorit 2013, ndërsa ndryshoi vetëm

pjesën lidhur me kamatën, duke gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, e cila paguhet nga bankat komerciale në Kosovë.

21. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme me arsyetimin për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 5 nëntor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 287/2019] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
24. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“se në përcaktimin e shumës së kompensimit të dëmit jopasuror, nuk janë marrë në mënyrë të drejtë të gjithë faktorët që ndikojnë në përcaktimin e shumës së të njëjtës, në radhë të parë në bazë të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, duhet të ishte marrë në konsideratë aktiviteti që ai po kryente ose sigurisht do të kryente në të ardhmen sipas rrjedhës së rregullt të ngjarjeve, kështu që kufizimi nënkupton kryerja e punës pas shkakimit të lëndimit trupor në këtë rast të veçantë, pala e dëmtuar, pas një muaji lëndimi, ishte në punën që po bënte para lëndimit, siç dëshmohet nga një vërtetim nga kompania ku ai punonte”*.
25. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Kur vendoset për shumën e dëmit jopasuror, është një gjykim në të cilin zbatohet standardi ligjor i ndershmërisë në matjen e kompensimit monetar dhe jo një shumë e madhe siç bëhet në këtë rast pa zbatuar nenet 182 dhe 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të cilën gjykata është e detyruar ta zbatojë, dhe siç nuk është bërë, d.m.th. të shpjegojë secilin prej llojeve individuale të dëmit jomaterial, kjo është arsyeja për fillimin e procedurave gjyqësore për të parandaluar abuzimin e të drejtave që u përkasin palëve”*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 287/2019] e 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
30. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Gjykata, në këtë aspekt dhe fillimisht, rikujton që parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar përgjatë gjithë procesit gjyqësor shumën e përcaktuar të kompensimit të dëmit dhe mënyrën se si është vlerësuar kjo shumë nga gjykatat e rregullta.
32. Çështja e parashtruesit të kërkesës lidhur me detyrimin e tij për kompensim të dëmit ndaj palës së dëmtuar, ishte shqyrtuar përmes tre (3) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore e sipas të cilës, detyroi parashtruesin e kërkesës që palës së dëmtuar, në emër të kompensimit të dëmit, për shkak të shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore t’ia paguaj vlerën e tërësishme prej 11.292,00 euro brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Ndërsa, Gjykata e Apelit dhe Supreme, respektivisht, kanë vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë konfirmuar detyrimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit.
33. Lidhur me këtë pretendim, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës në paragrafët 23-25 të këtij aktvendimi, përtej pretendimit se vendimet e gjykatave të rregullta *“në përcaktimin e shumës së kompensimit të dëmit jopasuror, nuk janë marrë në mënyrë të drejtë të gjithë faktorët që ndikojnë në përcaktimin e shumës së të njëjtës”* dhe në kundërshtim me Kushtetutën, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument dhe/ose arsyetim konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.
34. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
35. Një qëndrim i tillë i Gjykatës është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën Gjykata, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).

36. Gjykata gjithashtu rikujton që të njëjtat pretendime të përgjithshme përkitazi me përcaktimin e kompensimit të dëmit ishin paraqitur edhe para Gjykatës Supreme përmes revizionit, dhe e cila kishte theksuar këtë fakt përmes Aktgjykimit të saj [Rev. nr. 287/2019] të 5 nëntorit 2020, duke theksuar si në vijim:

“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykatat kanë pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos t’u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror, ashtu siç e parasheh neni 200, pika 2, i Ligjit për marrëdhëniet detyrimore”.

37. Përkundër këtij konstatimi, Gjykata Supreme në fakt kishte arsyetuar në mënyrë të detajuar pretendimet e përgjithësuara të parashtruesit të kërkesës përkitazi me vlerësimin e shumës së kompensimit të dëmit nën dritën e kualifikimeve të lëndimeve trupore të palës së dëmtuar. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:

“Të pabazuara janë pretendimet nga revizioni se eksperti i medicinës, kirurgu H. L., i cili ka vlerësuar lëndimet e paditësit në procedurën penale, në mënyrë të pasaktë i ka kualifikuar ato si lëndime të rënda trupore, sepse ato sipas mendimit të parashtruesit të revizionit, janë të lehta, për arsye se vetëm eksperti si profesionist nga fusha e kirurgjisë, është i thirrur të bëjë kualifikimin e lëndimeve, dhe ai këtë e ka bërë dhe se në procedurën penale gjetja e tij në tërësi është pranuar për shkak të cilës i padituri është përgjigjur për shkak të lëndimeve të rënda trupore. Gjetjet e ekspertit tjetër të medicinës, B. K., neurokirurg, në tërësi pajtohet me konstatimet e H. L., ashtu që ky revizion është plotësisht i pabazuar. Palët të cilat nuk posedojnë njohuri profesionale nga kjo lëmi, nuk mund të kontestojnë gjetjen e cili është dhënë sipas të gjitha rregullave të fushës dhe të shkathtësive, e i cili përmban edhe arsyetim”.

38. Gjykata në këtë kontekst thekson se gjykatat e rregullta dhe specifikisht Gjykata Supreme kishte konstatuar se caktimi i kompensimit të dëmit ishte në përputhje me dispozitat e LMD-së.
39. Siç u sqarua më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk sjellë asnjë argument apo arsyetim shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Për pasojë, Gjykata, bazuar në Rregulloren e saj të punës, përkatësisht paragrafin (2) të rregullit 39 të saj, duhet të shpallë këtë kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e ftij.
40. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, Aktvendim i 18 tetorit 2017, paragrafi 42).

41. Prandaj, në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
42. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20 e 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 30 mars 2022 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani

